

LIGJI NR. 08/L-307

**PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
MBRETËRISË SË DANIMARKËS PËR SHFRYTËZIMIN E INSTITUCIONIT KORREKTUES NË
GJILAN ME QËLLIM TË EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE DANEZE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
MBRETËRISË SË DANIMARKËS PËR SHFRYTËZIMIN E INSTITUCIONIT KORREKTUES NË
GJILAN ME QËLLIM TË EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE DANEZE**

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Traktatin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze, të nënshkruar nga Ministrat e Drejtësisë të të dy vendeve, më 26 prill 2022 në Prishtinë dhe 16 maj 2022 në Kopenhagë.

Neni 2

Dokumentet e bashkëngjitura

Në shtojcën e këtij Ligji është e bashkëngjitur teksti i Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-307

23 maj 2024

**Shpallur me dekretin Nr. DL-64/2024, datë 06.06.2024 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Vjosa Osmani-Sadriu**

*Ligji nr. 08/L-307 "Për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze", bashkëngjitur me Konventë janë publikuar në web faqen e Gazetës Zyrtare (gzk.rks-gov.net)

Traktat

ndërmjet Republikës së Kosovës dhe
Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institutit Korrektues në Gjilan
me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze

Republika e Kosovës dhe Mbretëria e Danimarkës (tutje "Partit"),

Duke marrë parasysh bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e ngushta dhe afatgjata ndërmjet Mbretërisë së Danimarkës dhe Republikës së Kosovës,

Duke ditur për kushtimin e përbashkët ndaj vlerave të përbashkëta themelore dhe duke dashur të zhvillojnë tutje marrëdhëniet ekzistuese të bashkëpunimit,

Me dëshirën që të fuqizojnë lidhjet dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e shërbimit të burgjeve, energjisë së gjelbër dhe promovimit të sundimit të ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut,

Duke ditur se Shërbimi Danez i Burgjeve dhe Sprovues po përballet me sfida për sa i përket infrastrukturës korrektuese në dispozicion,

Duke ditur zhvillimet pozitive në sistemin e shërbimit korrektues në Republikën e Kosovës dhe duke ditur se Republika e Kosovës me anë të një bashkëpunimi të tillë të intensifikuar do të ketë mundësinë që të fuqizojë më tej sistemin e saj të shërbimit korrektues,

Duke vënë në dukje se parimet e pëlqimit të lirë, mirëbesimit dhe rregullit pacta sunt servanda njihen botërisht dhe se ky Traktat do të bazohet në respektimin e të drejtave ndërkombëtare themelore të njeriut,

Duke dashur t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë,

Janë pajtuar si vijon:

PJESA I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 *Përdorimi i shprehjeve*

Për qëllime të këtij Traktati:

- a. "Shteti Dërgues" nënkupton: Mbretëria e Danimarkës;
- b. "Shteti Pranues" nënkupton: Republika e Kosovës;
- c. "Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues" nënkupton: Shërbimi Danez i Burgjeve dhe Sprovues;
- d. "Autoriteti i caktuar i Shtetit Pranues" nënkupton: Shërbimi Korrektues i Kosovës;
- e. "Burg" nënkupton: Institucionin Korrektues në Gjilan me kapacitet për të akomoduar 300 të Burgosur;
- f. "Governator" nënkupton: Governatori i Burgut i emëruar nga Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues;
- g. "Drejtor" nënkupton: Drejtori i Burgut i emëruar nga Autoriteti i caktuar i Shtetit Pranues për të menaxhuar Burgun dhe stafin e tij;
- h. "Stafi i Shtetit Dërgues" nënkupton: stafi i emëruar nga Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues;
- i. "Stafi i Shtetit Pranues" nënkupton: stafi i emëruar nga Autoriteti i caktuar i Shtetit Pranues;
- j. "i Burgosur" nënkupton: personi madhor ndaj të cilit është shqiptuar një dënim danez, përfshirë personat të cilëve Danimarka u ka shqiptuar urdhër dëbim, dhe personat që janë në paraburgim në pritje të ekzekutimit të një urdhër dëbimi, e të cilët transferohen në Shtetin Pranues;
- k. "Dënim danez" nënkupton: dënim me burg, përfshirë urdhrin për dëbim të shqiptuar me anë të një vendimi përfundimtar të gjykatës, i cili është i ekzekutueshëm në Shtetin Dërgues, dhe një urdhër gjykatë për paraburgim në pritje të ekzekutimit të një urdhër dëbimi;
- l. "Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve" nënkupton: njësi transportuese profesionale të Institucionit të Gjilanit, e cila shoqëron të Burgosurit për çfarëdo qëllimi në tërë territorin e Shtetit Pranues;
- m. "Njësia Shëndetësore e Burgut" nënkupton: shërbimi shëndetësor i cili gjendet në Burgun e Gjilanit, i përbërë nga stafi i Shtetit Dërgues, i cili ushtron detyrën sipas rregullave dhe rregulloreve të Shtetit Dërgues;
- n. "Marrëveshja e Bashkëpunimit" nënkupton: Marrëveshja ndërmjet Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Shërbimit Danez të Burgjeve dhe Sprovues për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze.

Neni 2 *Qëllimi dhe fushëveprimi*

1. Ky Traktat rregullon çështjet që kanë të bëjnë ose që rrjedhin nga ekzekutimi i dënimeve daneze në Burg, dhe përcakton kushtet e nevojshme për këtë qëllim gjatë ekzekutimit të dënimeve daneze, përfshirë çështjet lidhur me azilin në Shtetin Pranues, si dhe procedurën, të drejtat dhe detyrimet e të dyja Palëve.

2. Bashkëpunimi ndërmjet Shtetit Dërgues dhe Shtetit Pranues, përveç ekzekutimit të dënimeve daneze, mund të përfshijë në veçanti edukimin dhe trajnimin, shkëmbimin e praktikave dhe përvojave më të mira, fuqizimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare në shërbimet korrektuese, paraburgimin, si dhe mbështetjen dhe bashkëpunimin më të gjerë lidhur me sistemet dhe mekanizmat e shërbimit korrektues.

3. Ky Traktat përbën një instrument ligjërish të detyrueshëm sipas ligjit ndërkombëtar dhe rregullohet me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve (1969).

Neni 3

Zbatueshmëria e instrumenteve të tjera ndërkombëtare

Ky Traktat nuk do të paragjykojë, ndikojë apo prek të drejtat dhe detyrimet sipas të drejtës ndërkombëtare të asnjërës palë në këtë Traktat.

Neni 4

Detyrimet e ndërsjella

1. Ministri i Drejtësisë i Shtetit Pranues do ta vërë Burgun, përfshirë stafin dhe objektet e tij, në dispozicion të Ministrit të Drejtësisë të Shtetit Dërgues për qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze.

2. Shteti Pranues do të bëjë rregullimet e nevojshme në objektet e Burgut për të siguruar që Burgu të plotësojë kërkesat e Shtetit Dërgues. Shteti Pranues do të sigurojë që Burgu të plotësojë gjatë gjithë kohës kërkesat e Shtetit Dërgues siç ceket në fjalinë e mëparshme.

3. Ministri i Drejtësisë i Shtetit Dërgues do ta shfrytëzojë Burgun kundrejt një kompensimi, shifit Nenet 32 dhe 33, dhe në përputhje me këtë Traktat. Ekzekutimi i sanksioneve penale dhe masave të tjera në Burg bazohet ekskluzivisht në dënimet daneze.

4. Me qëllim të zbatimit të këtij Traktati, Autoritetet e caktuara të Shtetit Dërgues dhe të Shtetit Pranues do të lidhin një Marrëveshje Bashkëpunimi sa i përket funksionimit të Burgut, stafit, objekteve, transportit të të Burgosurve dhe detyrave të tjera që mund të kryhen nga të dyja Palët.

5. Ekzekutimi i të drejtave dhe detyrime sipas këtij Traktati dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit, duke përfshirë objektet e Burgut, transportin e të Burgosurve, hetimet penale, ndjekjen penale për veprat penale, dhe trajtimin brenda dhe jashtë Burgut, përfshirë kujdesin mjekësor, do të kryhen në përputhje me detyrimet sipas të drejtës ndërkombëtare të Shtetit Dërgues. Të dyja Palët në këtë Traktat do të sigurojnë përmbushjen e këtyre detyrimeve, përfshirë marrjen e masave të nevojshme për këtë qëllim.

Neni 5

Ligji i zbatueshëm

1. Rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues zbatohen ekskluzivisht për ekzekutimin e dënimeve daneze në Burg, përfshirë të drejtat dhe detyrimet e të burgosurve të cilat mund të marrin formën e ankesave ose veprimeve ligjore të të Burgosurve lidhur me ekzekutimin e dënimeve daneze.

2. Ankesat dhe çështjet ligjore lidhur me ekzekutimin e dënimeve daneze do të trajtohen nga autoritetet daneze, përfshirë gjykatat daneze.

3. Rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues lidhur me punësimin, kujdesin shëndetësor, mjedisin e punës dhe sigurinë do të zbatohen për Stafin e Shtetit Dërgues.

4. Rregullat dhe rregulloret e Shtetit Pranues lidhur me punësimin, kujdesin shëndetësor, mjedisin e punës dhe sigurinë do të zbatohen për Stafin e Shtetit Pranues.

5. Rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues lidhur me kushtet e punës, përfshirë mjedisin shëndetësor, sigurinë dhe sigurimin, do të zbatohen për të Burgosurit gjatë aktiviteteve të punës.

6. Kërkesat për azil të paraqitura nga të Burgosurit dhe çështjet tjera lidhur me azilin, do të trajtohen nga Shteti Dërgues në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues kur janë nën juridiksionin e Shtetit Dërgues.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e të Burgosurve

Të drejtat dhe detyrimet e të Burgosurve të përcaktuara në Nenin 5(1), ndër të tjera, në fushën e kujdesit shëndetësor, pjesëmarrjes në komunitetin e të Burgosurve, korrespondencës postare, shërbesave fetare, vizitave dhe komunikimit telefonik, do të rregullohen sipas rregullave dhe rregulloreve të Shtetit Dërgues siç specifikohet më tej në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

Neni 7

Të dhënat personale

1. Rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të Shtetit Dërgues, të përcaktuara në Nenin 5, ndër të tjera, përfshijnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë detyrimet ndërkombëtare të Shtetit Dërgues.

2. Të dhënat personale të shkëmbyera me Burgun në kuadër të zbatimit të këtij Traktati, do të përdoren vetëm për qëllimet e cekura në Nenin 2.

3. Në kontekst të këtij Traktati, të dhënat personale të dorëzuara Burgut nga ana e Shtetit Dërgues nuk do të zbulohen apo nuk do të jenë të qasshme për autoritetet e tjera në Shtetin Pranues ose për vendet e tjera jashtë Bashkimit Evropian dhe organizatat ndërkombëtare, përveç rasteve kur Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues ka dhënë autorizim paraprak për një zbulim të tillë.

4. Kërkesa për autorizim paraprak sipas paragrafit 3 nuk zbatohet në situatat e mëposhtme, përveç nëse Guvernatori e autorizon zbulimin:

- a. për të mbrojtur interesat jetike të të Burgosurit;
- b. për të kapur një të arratisur nga Burgu;
- c. për të parandaluar një kërcënim të atypëratyshëm dhe serioz ndaj sigurisë publike ose një rrezik ndaj shëndetit publik.

Ky paragraf zbatohet vetëm kur autorizimi paraprak sipas paragrafit 3 nuk mund të sigurohet me kohë. Autoriteti i caktuar në Shtetin Dërgues njoftohet lidhur me zbulimet e kryera në përputhje me këtë paragraf.

5. Në rast të një autorizimi paraprak sipas paragrafit 3 ose situatave të mbuluara me paragrafin 4, Burgu mund të zbulojë të dhënat përkatëse vetëm në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë detyrimet ndërkombëtare të Shtetit Dërgues, dispozitat për përpunimin e të dhënave personale dhe për transferimin e të dhënave personale në vende të treta ose organizata ndërkombëtare.

6. Duke pasur parasysh Nenin 30, Agjencia Daneze për Mbrojtjen e të Dhënave ka kompetencë të mbikëqyrë dhe të zbatojë përpunimin e të dhënave personale të kryera nga Burgu gjatë zbatimit të këtij Traktati.

PJESA II

BURGU

Neni 8 *Gjuha*

1. Gjuha e punës në Burg do të jetë gjuha angleze.
2. Të gjitha dokumentet zyrtare dhe dokumentacioni tjetër, sipas nevojës, hartohen ose përkthehen në gjuhën daneze ose angleze.
3. Kur është e nevojshme, dokumentet hartohen ose përkthehen në gjuhët zyrtare të Shtetit Pranes, siç specifikohet në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

Neni 9 *Kapacitetet e Burgut*

Shteti Pranes do të vërë në dispozicion kapacitete të përshtatshme për 300 të Burgosur në Burg për të Burgosurit e Shtetit Dërgues. Kapacitetet do të jenë në formën e qelive individuale ose qelive të përbashkëta për jo më shumë se dy të Burgosur në sipërfaqe jo më pak se 6 metra katrorë për qelitë individuale dhe jo më pak se 8 metra katrorë për qelitë e përbashkëta, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.

Neni 10 *Kushtet në Burg*

1. Shteti Pranes garanton që kushtet në Burg janë të tilla që Guvernatori të jetë në gjendje të sigurojë respektimin e plotë të rregullave dhe rregulloreve të Shtetit Dërgues, Traktatit dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
2. Në rast të ndryshimeve përmbytësore në rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues siç përmenden në paragrafin 1, Palët bien dakord të zhvillojnë konsultime, shih Nenin 37.

Neni 11 *Dëmtimi i pronës*

Dëmtimi i pronës së Burgut nga të Burgosurit si rezultat i përdorimit normal ose vandalizmit, mbulohet nga Shteti Pranes.

Neni 12 *Menaxhimi i parave të të Burgosurve*

Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues organizon administrimin e parave të të Burgosurve të fituara si rezultat i punësimit në Burg dhe mbulon të gjitha shpenzimet dhe pagat e të Burgosurve në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues. Gjatë administrimit të parave të të Burgosurve, Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues siguron që të mos krijohet asnjë marrëdhënie financiare ndërmjet Autoritetit të caktuar të Shtetit Pranes dhe të Burgosurve.

Neni 13

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Guvernatorit

1. Guvernatori udhëheq me Burgun.
2. Guvernatori, si pjesë e Stafit të Shtetit Dërgues, mund të emërojë deri në dy zëvendësguvernatorë dhe staf tjetër për të mbështetur Guvernatorin.
3. Brenda Burgut, Guvernatori është përgjegjës për ekzekutimin e duhur të dënimeve daneze, ruajtjen e rendit dhe sigurisë dhe trajtimin e të Burgosurve në përputhje me Ligjin Danez për Ekzekutimin e Dënimeve (*straffuldbyrdsesloven*) dhe rregullat dhe rregulloret tjera përkatëse të Shtetit Dërgues; përfshirë detyrimet ndërkombëtare të Shtetit Dërgues. Për këtë qëllim, në përputhje me paragrafin 5, Guvernatori do ta ketë në dispozicion dhe do ta udhëheq Stafin e Shtetit Pranues.
4. Në përputhje me paragrafin 3, Guvernatori do të autorizoj dhe do të jetë përgjegjës për përdorimin e forcës së drejtpërdrejtë ndaj të Burgosurve, përfshirë përdorimin e masave kufizuese në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë në Burg, sigurimit dhe parandalimit të arratisjeve, ekzekutimit të urdhër dëbimeve, apo shqyrtimit të rasteve për azil, shih Nenin 28.
5. Nën autoritetin, përgjegjësinë dhe urdhrat e Guvernatorit, Drejtori menaxhon Burgun dhe Stafin e Shtetit Pranues, shih Nenin 14.
6. Guvernatori mund t'i kërkojë Drejtorit të bëjë një ricaktim të detyrave të Stafit të Shtetit Pranues, p.sh. të mos kenë kontakt me të Burgosurit. Drejtori do të zbatojë një kërkesë të tillë pa vonesë dhe në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Pranues.
7. Guvernatori, ose stafi i emëruar nga Guvernatori, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesat e të Burgosurve rreth çështjeve të mbuluara me Nenin 5(1). Ankesat i dorëzohen Guvernatorit ose stafit të emëruar nga Guvernatori.

Neni 14

Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit

1. Nën autoritetin, përgjegjësinë dhe urdhrat e Guvernatorit, përgjegjësitë e Drejtorit janë:
 - a. të sigurojë përmbushjen e të gjitha detyrimeve të Shtetit Pranues sipas këtij Traktati dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit për të siguruar funksionimin e duhur dhe të ligjshëm të Burgut dhe për të menaxhuar Stafin e Shtetit Pranues për qëllimet e këtij Traktati;
 - b. të lehtësojë komunikimin me autoritetet përkatëse të Shtetit Pranues;
 - c. të urdhërojë përdorimin e masave shtrënguese për qëllimet e këtij Traktati;
 - d. ta ndihmojë Guvernatorin në hartimin e rregullave dhe procedurave standarde me qëllim të funksionimit praktik dhe menaxhimit efektiv të Burgut; dhe
 - e. të zbatojë rregullat dhe procedurat e stafit të Shtetit Pranues lidhur me ekzekutimin e dënimeve daneze.
2. Drejtori, në konsultim me Guvernatorin, përgatit raport mbi planin vjetor të buxhetit për funksionimin kosovar të Burgut dhe ia paraqet për miratim Autoritetit të caktuar të Shtetit Pranues.
3. Drejtori, pa cenuar Nenin 13(6), ndërmerri masa të menjëhershme dhe fillon procedurën disiplinore ndaj Stafit të Shtetit Pranues në rast të shkeljeve të lidhura me stafin.

4. Drejtori i raporton në baza të rregullta Guvernatorit dhe Drejtorit të Autoritetit të caktuar të Shtetit Pranues lidhur me funksionimin e Burgut.
5. Drejtori mund të ketë së paku një zëvendës drejtor për të mbështetur Drejtorin.

Neni 15
Staffi

1. Shteti Pranues siguron stafin e nevojshëm për zbatimin e Traktatit dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit. Numri i Stafit të kualifikuar të Shtetit Pranues do të rregullohet po ashtu me Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Stafit do të trajnohet në përputhje me standardet dhe rregulloret e rëna dakord në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.
2. Shteti Dërgues mund të sigurojë staf të uniformuar për qëllime edukimi dhe trajnimi. Stafit i Shtetit Dërgues, në raste të vetëmbrojtjes gjatë edukimit dhe trajnimit të stafit të Shtetit Pranues, do ta ketë autoritetin të përdorë masa shtrënguese ndaj të burgosurve dhe të marrë masat e nevojshme në përputhje me Ligjin Danez për Ekzekutimin e Dënimeve.

PJESA III

EKZEKUTIMI I DËNIMEVE

Neni 16
Transferi dhe vendosja e të burgosurve

1. Përpara transferimit të të Burgosurve, Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues njofton Autoritetin e caktuar të Shtetit Pranues për të Burgosurit që pritet të transferohen dhe të vendosen në Burg, siç specifikohet më tej në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.
2. Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues duhet të njoftojë Autoritetin e caktuar të Shtetit Pranues për të dhënat përkatëse të nevojshme për të trajtuar të Burgosurin individual. Pjesë e njoftimit do të jenë edhe të dhënat specifike në lidhje me vlerësimin individual të rrezikut të sigurisë.
3. Nëse është e nevojshme, Shteti Pranues mund të kërkojë të dhëna shtesë për të Burgosurin me qëllim të trajtimit të të Burgosurit, shih Nenin 7.
4. Shteti Dërgues nuk do të dërgojë të Burgosur të dënuar për vepra terroriste, të Burgosur të dënuar për krime lufte dhe të Burgosur të cilëve, në kohën e vendimit për vendosje në Burg, u është konfirmuar diagnozë terminale dhe/ose çrregullime të rënda mendore për të cilat nevojitet kujdes mjekësor jashtë Burgut.
5. Pa cenuar paragrafin 4, në raste të jashtëzakonshme do të zhvillohen konsultime ndërmjet Autoriteteve të caktuara të Shtetit Dërgues dhe të Shtetit Pranues, siç specifikohet në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

Neni 17
Ekzekutimi i largimit dhe Iritimit

1. Çdo vendim i marrë në Shtetin Dërgues sipas të cilit një të Burgosuri i lejohet të largohet nga Burgu, qoftë përkohësisht apo në raste tjera, nuk do të ekzekutohet në territorin e Shtetit Pranues, përveç në rastet kur i Burgosuri është shtetas ose banor i Shtetit Pranues. Megjithatë, në raste

individuale, Guvernatori mund të lejojë një largim të përkohshëm, nën përcjelljen e Njësisë për Përcjelljen e të Burgosurve në territorin e Shtetit Pranues.

2. Të Burgosurit do të transferohen përsëri në Shtetin Dërgues para lirimit të tyre, përveç rasteve kur i Burgosuri është shtetas ose banor i Shtetit Pranues apo ekziston mirëkuptim ndërmjet Shtetit Dërgues dhe një Shteti të tretë për transferimin e të Burgosurit në Shtetin e tretë pas lirimit.

Neni 18 *Transporti i të Burgosurve*

1. Të Burgosurit do të transportohen nga Shteti Dërgues në Shtetin Pranues dhe nga Shteti Pranues në një vend të tretë ose në Shtetin Dërgues, dhe transporti do të kryhet nga Autoritetet e caktuara të Shtetit Dërgues. Në qoftë se i Burgosuri do të transferohet në një vend të tretë pas lirimit, transporti i të Burgosurit nga territori i Shtetit Pranues mund të bëhet me fluturime komerciale ose me mënyra të tjera transportuese nga kufiri për në një vend të tretë. Transporti nga dhe prej kufirit të Shtetit Pranues për në Shtetin Dërgues ose për në një vend të tretë do të organizohet dhe kryhet nga Shteti Dërgues sipas rregullave dhe rregulloreve të Shtetit Dërgues.

2. Për sa i përket pranim-dorëzimit, Stafit i Shtetit Dërgues mund të kryejë procedura sigurie në një zonë të caktuar, përfshirë kontrollin trupor ose masa të tjera shtrënguese, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues dhe, sipas nevojës, ndihmohet nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve ose stafi mjekësor i Shtetit Dërgues. Në lidhje me këtë të fundit, do të zbatohet Neni 19(5). Pranim-dorëzimi i të Burgosurit do të rregullohet më tej me Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

3. Transporti i të Burgosurve në territorin e Shtetit Pranues nga Burgu dhe për në Burg do të bëhet me urdhër të Guvernatorit ose Autoritetit të caktuar të Shtetit Dërgues dhe do të kryhet nga Stafit i Shtetit Pranues, i caktuar nga Autoriteti kompetent i Shtetit Pranues sipas rregullave dhe rregulloreve të Shtetit Pranues dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shtetit Dërgues.

4. Gjatë transportit të të Burgosurve, masat shtrënguese, përfshirë përdorimin e masave kufizuese, mund të përdoren nga Stafit i caktuar i Shtetit Pranues për arsye sigurie dhe për kryerjen e papenguar të transportit në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shtetit Dërgues gjatë një transporti të tillë.

5. Në përputhje me Nenin 13, Guvernatori ose personat e caktuar nga Guvernatori, mund të marrin pjesë si vëzhgues në transportin e kryer nga Stafit i Shtetit Pranues.

6. Guvernatori është i autorizuar të shqiptojë sanksione ndaj çdo shkeljeje disiplinore të kryer nga një i Burgosur gjatë transportit nga Burgu dhe për në Burg, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.

Neni 19 *Kujdesi mjekësor brenda dhe jashtë Burgut*

1. Në qoftë se një i Burgosur ka nevojë për kujdes mjekësor, i Burgosuri transferohet në një qendër mjekësore në Shtetin Dërgues.

2. Përbashimisht nga paragrafi 1, i Burgosuri mund të gëzojë kujdes mjekësor:

- a. brenda Burgut, në rastet kur trajtimi nuk kërkon transportim për në Shtetin Dërgues ose pranim në një qendër mjekësore, shih pikët b dhe c. Kujdesi mjekësor në Burg do të afrohet nga Shteti Dërgues në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues;

- b. jashtë Burgut, në një qendër mjekësore në Shtetin Pranues në rastet kur trajtimi i të Burgosurit kërkon pranim në një qendër mjekësore për jo më shumë se 3 netë;
- c. jashtë Burgut, në një qendër mjekësore në Shtetin Pranues në rastet kur për arsye mjekësore nuk është i mundur transferimi në një qendër mjekësore në Shtetin Dërgues. Nëse është e nevojshme, i Burgosuri do të transferohet në Shtetin Dërgues sapo t'ia mundësojë gjendja e tij mjekësore.

3. Vendimi për transferimin e një të Burgosuri në një qendër mjekësore në Shtetin Dërgues do të merret nën autoritetin e Guvernatorit.

4. Profesionistët mjekësorë, produktet mjekësore dhe barnat brenda Burgut sigurohen nga Shteti Dërgues në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.

5. Me qëllim të funksionimit të Njesisë Shëndetësore të Burgut:

- a. profesionistëve mjekësorë të Shtetit Dërgues që punojnë në Njesisë Shëndetësore të Burgut nuk do t'u kërkohej t'i nënshtrohen asnjë procedure për të huajt që punojnë në Shtetin Pranues;
- b. licencimi i Njesisë Shëndetësore të Burgut dhe importi i produkteve mjekësore dhe barnave me qëllim të ofrimit të shërbimeve mjekësore në Burg nuk kërkohej tu nënshtrohen procedurave të Shtetit Pranues;
- c. mbetjet mjekësore dhe barnat e skaduar do të menaxhohen në Shtetin Pranues nga Njësia Shëndetësore e Burgut;
- d. në rast të përfundimit të Traktatit, të gjitha pajisjet mjekësore kthehen në Shtetin Dërgues;
- e. në rastet e cekura në paragrafin 2 (b) dhe (c), të Burgosurit pranohen në një qendër mjekësore në Shtetin Pranues.

6. Gjatë qëndrimit në një qendër mjekësore jashtë Burgut në Shtetin Pranues, i Burgosuri trajtohet në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Pranues dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shtetit Dërgues. Trajtimi që do të ofrojë një qendër mjekësore e Shtetit Pranues, shih paragrafin 2 (b) dhe (c), do të ofrohet sipas një procedure lehtësuese dhe efektive, e cila duhet të përfshijë pikat e kontaktit ndërmjet Burgut dhe qendrave mjekësore përkatëse në Shtetin Pranues. Shteti Pranues do të sigurojë vendosjen e kësaj procedure. Palët mund të konsultohen me synimin për të ofruar, kur është e nevojshme ose në rastet me diagnozë terminale për të cilat transporti nuk është i mundur, trajtim mjekësor në objektet përcjellëse për aq sa një trajtim i tillë do të ishte më i përshtatshëm për të siguruar detyrimet e Shtetit Dërgues të cekura në këtë paragraf.

7. I Burgosuri ruhet nga Njësia për Përcjelljen e të të Burgosurve e cila mund të përdorë masa shtrënguese, përfshirë masat kufizuese, për arsye sigurimi dhe parandalimi të arratisjes, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe detyrimet sipas të drejtës ndërkombëtare të Shtetit Dërgues.

8. I Burgosuri i transferuar në një qendër mjekësore për qëllime mjekësore emergjente, duhet të shoqërohet me dosje mjekësore dhe me kartë identifikuese të përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të Shtetit Pranues, përfshirë informacionin standard, siç rregullohet më tej me Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

9. Njësia Shëndetësore e Burgut e pranon dosjen mjekësore të pacientit nga qendra mjekësore e Shtetit Pranues në të cilën i Burgosuri i është nënshtuar trajtimit.

Neni 20

Vdekja e të Burgosurit, tentativat e kualifikuara si vetëvrasje dhe veprimet ose sjelljet e tjera të kualifikuara si vetëdëmtuese

1. Në rast vdekjeje, përfshirë vetëvrasjen dhe tentim-vetëvrasjen, të një të Burgosuri në Burg dhe jashtë Burgut, Guvernatori informon menjëherë autoritetet përkatëse të Shtetit Pranues, përgatit një raport lidhur me rastin dhe, nëpërmjet Drejtorit, ia dërgon autoriteteve përkatëse të Shtetit Pranues.
2. Më pas, Guvernatori ndjek të gjitha udhëzimet e autoriteteve kompetente të Shtetit Pranues, u mundëson qasje në Burg, i lejon të kryejnë çdo hetim të nevojshëm penal për shkakun e vdekjes, dhe u ofron çdo ndihmë tjetër në këtë drejtim.
3. Guvernatori do të lejojë transportimin e të ndjerit me urdhër të autoriteteve kompetente të Shtetit Pranues nga Burgu në një vend për ekzaminim të mëtejshëm rreth shkakut të vdekjes.
4. Guvernatori organizon transferimin e të ndjerit për në Shtetin Dërgues ose në një vend të tretë, sa më shpejt që të jetë e mundur.
5. Pas ndjekjes së procedurës së përcaktuar në paragrafin 1, në rast të vdekjes së një të Burgosuri dhe në rast të tentativave të kualifikuara si vetëvrasje, veprimeve të tjera të kualifikuara si vetëdëmtuese, dhe sjelljeve të tjera vetëvrasëse dhe vetëdëmtuese, Guvernatori përgatit raport për autoritetet përkatëse të Shtetit Dërgues. Guvernatori më pas ndjek të gjitha udhëzimet e Shtetit Dërgues.
6. Hetimet administrative dhe mbikëqyrëse në Burg në lidhje me ngjarjet e cekura në paragrafin 5, mund të kryhen nga autoritetet përkatëse të Shtetit Dërgues në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.
7. Me kërkesë të Guvernatorit ose, kur është e nevojshme, të autoriteteve kompetente të Shtetit Dërgues, ata do të informohen për hetimet dhe rezultatet e ndjekjes penale në zhvillim e sipër.

Neni 21

Arratisja

Në rast arratisjeje nga Burgu, p.sh. gjatë transportit ose gjatë qëndrimit në një qendër mjekësore në Shtetin Pranues, Guvernatori informon menjëherë policinë e Shtetit Pranues, Autoritetin e caktuar të Shtetit Pranues, dhe autoritetet përkatëse të Shtetit Dërgues, dhe u siguron atyre identitetin e personit në fjalë dhe informacione të tjera të rëndësishme.

Neni 22

Siguria e Burgut

1. Autoritetet kompetente të Shtetit Pranues janë përgjegjëse për zbatimin e rendit dhe sigurisë publike jashtë Burgut. Ato ndërmarrin masat e nevojshme për funksionimin e papenguar të Burgut dhe, kur është e nevojshme, masa për të parandaluar prishjen e rendit publik në afërsi të Burgut.
2. Sigurimi brenda Burgut është përgjegjësi e Guvernatorit, në përputhje me Nenin 13(3). Me kërkesë të Guvernatorit, në situata të jashtëzakonshme kur staff i Burgut nuk është më në gjendje të garantojë sigurinë dhe rendin në Burg, organet kompetente të Shtetit Pranues janë përgjegjëse për zbatimin e sigurisë dhe rendit publik brenda Burgut. Një zbatim i tillë i sigurisë ose rendit publik duhet të kryhet në konsultim të ngushtë me Guvernatorin dhe të kryhet me ndërhyrjen më të vogël të mundshme dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Sapo të rivendoset rendi dhe

siguria publike, siguria e Burgut është sërish përgjegjësi e Guvernatorit. Kjo çështje do të rregullohet më tej me Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

Neni 23

Evakuimi i Burgut në raste emergjente

1. Në qoftë se Burgu duhet të evakohet në raste emergjente, të Burgosurit transferohen në një vend tjetër të caktuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Pranues, me synim të kthimit të tyre të menjëhershëm në Shtetin Dërgues.

2. Ky Traktat dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit zbatohen *mutatis mutandis* edhe për lokacionin tjetër, siç ceket në paragrafin 1, për aq sa lejojnë rrethanat emergjente.

PJESA IV

LIGJI PENAL

Neni 24

Veprat penale të kryera në Shtetin Pranues

1. Veprat penale të kryera në Shtetin Pranues ndiqen penalisht në Shtetin Pranues. Në raste të jashtëzakonshme dhe në lidhje me juridiksionin e Shtetit Dërgues dhe parimin *ne bis in idem*, veprat penale të kryera kundër Stafit ose nga Stafit i Shtetit Dërgues mund të ndiqen penalisht në Shtetin Dërgues pas konsultimit ndërmjet autoriteteve përkatëse të Shtetit Dërgues dhe Shtetit Pranues.

2. Guvernatori, nëpërmjet Drejtorit, është i obliguar t'i raportojë të gjitha veprat penale tek organet përkatëse. Autoritetet përkatëse menjëherë e informojnë Prokurorin e Shtetit të Shtetit Pranues lidhur me raportimin.

3. Guvernatori bashkëpunon në çdo hetim brenda Burgut që konsiderohet i nevojshëm nga autoritetet përgjegjëse të Shtetit Pranues për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.

4. Me kërkesë të Guvernatorit ose, kur është e nevojshme, të autoriteteve kompetente të Shtetit Dërgues, ata do të informohen rreth hetimeve dhe rezultatit të ndjekjes penale në zhvillim e sipër.

5. Intervistimi i të Burgosurve si të dyshuar ose dëshmitarë dhe veprimet e tjera hetimore që i prekin ata, në rastet kur e lejojnë interesat e hetimit, kryhen brenda Burgut për aq sa është e mundur.

6. I Burgosuri i dyshuar për një vepër penale të kryer në Burg nuk mund të transferohet në Shtetin Dërgues përveçse me pëlqimin e autoriteteve përkatëse të Shtetit Pranues.

7. Autoritetet e Shtetit Dërgues nuk lejohen të fillojnë hetime në Burg për veprat penale të kryera në Shtetin Pranues, përveç rasteve kur kjo lejohet në përputhje me paragrafin 1 apo Nenin 26. Megjithatë, Guvernatorit, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues, i lejohet të kryejë hetime me qëllim vendosjen e një sanksioni disiplinor ndaj një të Burgosuri të përfshirë në një vepër penale.

8. Ky nen nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Nenin 4 (5) dhe Nenin 31.

Neni 25

Ekzekutimi i një dënimi të shqiptuar nga Shteti Pranues

1. Në rastet kur një i Burgosur dënohet me burgim në Shtetin Pranues, shih Nenin 24, ekzekutimi i dënimit dënohet pezullohet dhe i Burgosuri transferohet pa vonesë në një institucion tjetër paraburgimi në Shtetin Pranues për të vuajtur dënimin e Shtetit Pranues.
2. Ekzekutimi dhe shqiptimi i dënimit nga Shteti Pranues do të jetë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shtetit Dërgues.
3. Pas përfundimit të vuajtjes së dënimit të Shtetit Pranues, i Burgosuri kthehet në Burg për të vazhduar dhe përfunduar ekzekutimin e dënimit dënohet.
4. Në qoftë se Traktati ndërpritet në përputhje me Nenin 35, të Burgosurit që vuajnë dënimin e Shtetit Pranues në një institucion tjetër paraburgimi në Shtetin Pranues, transferohen sa më shpejt që të jetë e mundur në Shtetin Dërgues për të vuajtur dënimin e Shtetit Pranues në Shtetin Dërgues, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shtetit Dërgues dhe me parimet e Konventës së Këshillit të Evropës për Transferimin e Personave të Dënuar.

Neni 26

Hetimet e lryera nga Shteti Dërgues

1. Autoritetet përkatëse të Shtetit Dërgues, brenda Burgut dhe sipas rregullave dhe rregulloreve të Shtetit Dërgues, mund të nisën hetime dhe hetime penale për veprat e mbuluara nga juridiksioni i Shtetit Dërgues dhe mund të intervistojnë të Burgosurit si të dyshuar apo dëshmitarë.
2. Në rast se një i Burgosur duhet të intervistohet si i dyshuar apo si dëshmitar nga autoritetet kompetente të Shtetit Dërgues, mund të bëhen aranzhime, përfshirë përdorimin e komunikimit tjetër virtual të sigurt, sipas rregullave dhe rregulloreve të Shtetit Dërgues.
3. Në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues, Guvernatori mund të monitorojë p.sh. telefonatat, vizitat dhe korrespondencat e të Burgosurit. Burgu dhe sistemet teknike duhet të jenë në gjendje të mundësojnë monitorimin. Shteti Dërgues do të sigurojë pajisjet për monitorim.

Neni 27

Bashkëpunimi juridik me kërkesë të Shteteve të treta

1. Në rast se autoritetet kompetente të Shtetit Pranues pranojnë kërkesë për ekstradim, ose kërkesë për ndihmë juridike nga një Shtet i tretë në lidhje me një të Burgosur në Burg, kjo i përcillet autoriteteve kompetente të Shtetit Dërgues. Në situatat e cekura në Nenin 25, Shteti Pranues nuk do të aprovoj kërkesën për ekstradim ose ndihmë juridike nga një Shtet i tretë pa pëlqim paraprak të Shtetit Dërgues. E njëjta gjë vlen për kërkesat nga gjykatat ndërkombëtare.
2. Në rast se autoritetet kompetente të Shtetit Dërgues pranojnë kërkesë për ekstradim, urdhër arrest evropian ose një kërkesë për ndihmë juridike nga një Shtet i tretë në lidhje me një të Burgosur në Burg, kjo do të trajtohet nga Shteti Dërgues me qëllim të shqyrtimit dhe ekzekutimit të tyre. E njëjta gjë vlen edhe për kërkesat nga gjykatat ndërkombëtare. I Burgosuri rikthehet në Shtetin Dërgues kur dhe nëse është e përshtatshme.

PJESA V

AZILI

Neni 28

Shqyrtimi i rasteve lidhur me azilin

1. Autoritetet përkatëse të Shtetit Dërgues, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues, ndër të tjera, mund të kryejnë intervista me të Burgosurit ose t'u marrin gjurmët e gishtërinjve dhe të fotografojnë të Burgosurit me qëllim të përfundimit të shqyrtimit të rasteve lidhur me azilin dhe ankesave kundër vendimeve rreth azilit, si dhe të zhvillojnë procedura gojore pranë Bordit Danez për Ankesa të Refugjatëve.
2. Avokatët ose organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime ligjore mund të lejohen ta bëjnë këtë në Burg, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.
3. Në rast se një i Burgosur intervistohet ose i ofrohen shërbime ligjore lidhur me një çështje që ka të bëjë me azilin, shih paragrafët 1 dhe 2, mund të bëhen përgatitje për ta lehtësuar atë proces, e të cilat mund të përfshijnë përdorimin e komunikimit të sigurt përmes internetit në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.

PJESA VI

PRIVILEGJET DHE IMUNITETET

Neni 29

Mjediset e Burgut

1. Mjediset e Burgut janë të pacenueshme dhe në to mund të hyhet vetëm me leje të Guvernatorit.
2. Leja, siç përcaktohet në paragrafin 1, konsiderohet të jetë marrë në rast zjarri ose aksidenti në Burg, fatkeqësie apo krize të madhe në Burg ose me pasoja për Burgun, me ç'rast menjëherë duhet të ndërmerren masa mbrojtëse.
3. Autoritetet e caktuara të Shtetit Dërgues dhe Shtetit Pranues do të bëjnë aranzhime të përshtatshme për të lejuar përfaqësuesit e autorizuar të shërbimeve publike dhe inspektimeve të nevojshme për të hyrë në Burg.

Neni 30

Mbikëqyrja, hetimet dhe ankesat apo veprimet ligjore të të Burgosurve

1. Mbikëqyrja dhe zbatimi i ekzekutimit të dënimeve përcaktohet me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues. Kjo përfshin detyrën e Guvernatorit për të mbikëqyrur ekzekutimin e duhur të dënimeve, në lidhje me të cilat Guvernatori do të ketë të njëjtat kompetenca dhe qasje siç ceket në paragrafin 3 më poshtë.
2. Mekanizmat ndërkombëtar, siç është Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues, janë të autorizuar për të bërë vizita të parajmëruara dhe të paparajmëruara në Burg dhe lidhur me transportin sipas Nenit 18 dhe transferimin dhe trajtimin sipas Nenit 19. Autoritetet e Shtetit Dërgues dhe Shtetit Pranues u

mundësojnë atyre qasje në informacion dhe i lejojnë të intervistojnë të Burgosurit në masën më të madhe të mundshme.

3. Autoritetet e Shtetit Dërgues që janë kompetente për tu marrë me ankesat, veprimet ligjore dhe/ose mbikëqyrjen, siç është Avokati Parlamentar i Popullit, mund të kryejnë hetime në Burg lidhur me detyrimet e Shtetit Dërgues sipas këtij Traktati, përfshirë obligimet gjatë transportit sipas Nenit 18 dhe gjatë transferimit dhe trajtimit sipas Nenit 19. Në këtë drejtim, këto autoritete gëzojnë të njëjtat kompetenca sikur që gëzojnë sipas rregullave dhe rregulloreve të Shtetit Dërgues, përfshirë qasjen në vendndodhjet dhe informacionin përkatës, deklaratat me shkrim nga Burgu dhe të drejtën për të intervistuar të Burgosurit dhe stafin në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.

4. Avokati i Popullit i Shtetit Pranues mund të kryejë hetime në lidhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Pranues, kur kjo bëhet sipas këtij Traktati dhe në përputhje me mandatin e Avokatit të Popullit.

5. Avokatët dhe organizatat nga Shteti Dërgues që ofrojnë shërbime ligjore për të Burgosurit, lejohen ta bëjnë këtë në Burg.

Neni 31

Imuniteti i Guvernatorit, stafit dhe autoriteteve kompetente të Shtetit Dërgues

1. Guvernatori dhe Stafi i Shtetit Dërgues gëzojnë imunitet nga juridiksioni i Shtetit Pranues në lidhje me veprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Kjo vlen edhe për autoritetet e cekura në Nenin 30(3).

2. Imuniteti i paraparë në paragrafin 1 jepet në interes të zbatimit të duhur të këtij Traktati dhe jo për përfitime personale të Guvernatorit, Stafit dhe autoriteteve të Shtetit Dërgues. Shteti Dërgues *ex officio* ose me kërkesë të Shtetit Pranues, ka për detyrë t'ia heqë imunitetin Guvernatorit, Stafit dhe autoriteteve të Shtetit Dërgues në çdo rast kur mos heqja e imunitetit do të pengonte rrjedhën e drejtësisë. Imuniteti mund të hiqet pa parajlykuar qëllimin për të cilin është rënë dakord.

3. Imuniteti i paraparë në paragrafin 1 nuk e përjashton stafin nga juridiksioni i Shtetit Dërgues.

4. Pavarësisht se ku ndodhen, të gjitha dosjet, dokumentet dhe bartësit e tjerë të të dhënave të Shtetit Dërgues që Guvernatori ose Stafi i Shtetit Dërgues kanë në zotërim gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, janë të paprekshme. Shteti Pranues mund të kërkojë qasje në dokumentet përkatëse dhe kjo do të rregullohet më tej me Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

5. Imuniteti në lidhje me pronën, asetet dhe sendet tjera relevante do të rregullohet më tej me Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

6. Guvernatori dhe Stafi i Shtetit Dërgues nuk do t'i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat në Shtetin Pranues me kusht që Guvernatori dhe Stafi i Shtetit Dërgues gjatë qëndrimit të tyre në Shtetin Pranues i nënshtrohen plotësisht tatimit në Shtetin Dërgues, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.

7. Ky nen zbatohet *mutatis mutandis* për veprimet dhe Stafin e Shtetit Dërgues të përcaktuara në Nenin 18(2).

PJESA VII

KOSTOT

Neni 32

Tarifa për shfrytëzimin e Burgut

1. Tarifa do të jetë një shumë vjetore e vazhdueshme fikse prej 15,000,000 € (*pesëmbëdhjetë milionë*), e cila do të vihet në dispozicion të Shtetit Pranues në shuma tremujore prej 3,750,000 € (*tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë*).

2. Tarifa e cekur në paragrafin 1 do të paguhet e plotë në baza vjetore në shuma tremujore duke filluar nga koha kur Burgu përgatitet plotësisht dhe kompletohet me staf për të akomoduar 300 të burgosur sipas standardeve dhe kërkesave ligjore të Shtetit Dërgues, shih paragrafin 5, jo më vonë se 12 muaj pas pagesës së parë të tarifës siç përshkruhet në paragrafin 4.

Në çdo rast kur Burgu nuk i plotëson kërkesat e cekura në fjalinë e parë, shumat e tarifës fikse vjetore do të ulen në një shumë që korrespondon me numrin përkatës të të burgosurve nga 300 të Burgosurit e synuar që mund të vendosen në Burg sipas standardeve dhe kërkesave ligjore të Shtetit Dërgues. Shuma e reduktuar e cekur në fjalinë e tretë do të zbatohet derisa të plotësohen kërkesat e cekura në fjalinë e parë.

3. Me hyrjen në fuqi të Traktatit, një tarifë fillestare prej 5,000,000 € (*pesë milionë*) do t'i vihet në dispozicion Shtetit Pranues për të mbuluar periudhën e tranzicionit derisa Burgu të jetë përgatitur dhe pajisur me staf siç përcaktohet në paragrafin 4. Tarifa fillestare do të jetë si shtesë e pagesave të mëvonshme të vazhdueshme vjetore për shfrytëzimin e Burgut siç përshkruhet në paragrafin 1 dhe 2.

4. Për 12 muajt e parë të shfrytëzimit të Burgut, shih paragrafin 5, tarifa do të paguhet në shuma tremujore në përputhje me numrin e të Burgosurve për të cilët objekti është përgatitur dhe është plotësuar me staf, duke filluar nga data e përgatitjes së Burgut për 100 të Burgosur në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.

Shumat tremujore të tarifës, siç përcaktohen në fjalinë e parë të këtij paragrafi, nuk do të kalojnë shumën prej 1,250,000 € (*një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë*) për tremujorin e parë, 1,875,000 € (*një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë*) për tremujorin e dytë, 2,500,000 € (*dy milionë e pesëqind mijë*) për tremujorin e tretë, dhe 3,125,000 € (*tre milionë e njëqind e njëzet e pesë*) për tremujorin e katërt. Shumat tremujore të tarifës për 12 muajt e parë të shfrytëzimit të Burgut, siç përcaktohen në fjalinë e parë dhe të dytë të paragrafit 4, së bashku nuk do të kalojnë shumën prej 0,750,000 € (*tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë*).

5. Data e cekur në fjalinë e parë të paragrafit 2 dhe paragrafit 4 do të përcaktohet përmes një raporti të inspektimit i cili do të rregullohet më tej me Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Pa paragjykur Nenin 4 (2), fjalinë e dytë dhe Nenin 10 (2), për sa i përket raportit të inspektimit, në Marrëveshje të Bashkëpunimit duhet të parashihet që kërkesat dhe kushtet përkatëse të Shtetit Dërgues janë përmbushur me rastin e nënshkrimit të raportit të inspektimit nga Grupi Teknik i Shtetit Pranues dhe Shtetit Dërgues dhe miratimit nga Komiteti i Përbashkët Drejtues.

Neni 33
Kosto tjeru

Shteti Dërgues nuk do të jetë përgjegjës për asnjë kosto tjetër të shkaktuar nga Shteti Pranues përveç tarifës së cekur në Nenin 32.

PJESA VIII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 34
Kohëzgjatja e shfrytëzimit të Burgut

1. Shteti Pranues do ta vërë Burgun në dispozicion të Shtetit Dërgues dhe Shteti Dërgues do ta shfrytëzojë Burgun për pesë (5) vite nga hyrja në fuqi e Traktatit.
2. Afati i shfrytëzimit të Burgut do të zgjater automatikisht për një periudhë shtesë pesë (5) viteve, përveç nëse ndonjëra nga Palët njofton Palën tjetër, sipas procedurës së përshkruar në Nenin 35, rreth synimit të saj për të ndërprerë këtë Traktat, së paku dymbëdhjetë (12) muaj para përfundimit të afatit të shfrytëzimit të Burgut sipas paragrafit 1.

Neni 35
Ndërprerja e Traktatit

1. Ky Traktat mund të ndërpritet nga Shteti Dërgues ose Shteti Pranues në çdo kohë, duke i ofruar një njoftim me shkrim Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ndërprerja hyn në fuqi 12 muaj pas datës së pranimit të njoftimit.
2. Ndërprerja e këtij Traktati nuk do të ndikojë në asnjë të drejtë ose detyrim që lind nga zbatimi i këtij Traktati dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit përpara ndërprerjes së tillë.
3. Në rast të ndërprerjes së këtij Traktati, të dhënat personale që i janë dorëzuar Burgut nga Shteti Dërgues, nëse gjykohet e nevojshme nga Guvernatori, do të vazhdojnë të përpunohen në përputhje me rregullat e cekura në Nenin 7, do të kthehen apo do të fshihen në përputhje me udhëzimet nga Autoriteti i caktuar i Shtetit Dërgues.

Neni 36
Aranzimet shtesë

Për qëllime të zbatimit praktik të këtij Traktati, përfaqësuesit e Shtetit Dërgues dhe të Shtetit Pranues mund të bëjnë aranzime shtesë.

Neni 37
Konsultimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Autoritetet e caktuara të Shtetit Dërgues dhe Shtetit Pranues, ose përfaqësuesit e tyre të caktuar nga Ministritë përkatëse të Drejtësisë, do të konsultohen për zbatimin e këtij Traktati nëse lind nevoja. Çdo dallim ose mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Traktati do të zgjidhet me negociata midis Palëve.
2. Me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit praktik të Traktatit dhe sigurimit të dialogut të mjaftueshëm në këtë drejtim, do të themelohet një Komitet i Përbashkët Drejtues. Komiteti do të përbëhet prej

tre personave nga secila Palë me autoritet për të vepruar në emër të asaj Pale. Ata do të takohen rregullisht dhe do t'i raportojnë Ministrave të Drejtësisë së paku dy herë në vit.

3. Komiteti i Përbashkët Drejtues do të ketë kompetencë për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që lind nga ky Traktat dhe nga Marrëveshja e Bashkëpunimit, përveç rasteve kur përjashtohet në mënyrë specifike. Komiteti do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Traktati dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përfshirë miratimin e raportit të inspektimit. Përbërja, autorizimet, dhe përgjegjësitë e Komitetit do të përcaktohen me Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

4. Për qëllime të konsultimit dhe mbikëqyrjes së përmbushjes së kërkesave të specifikuara në Burg nga ana e Shtetit Dërgues, do të krijohet një grup punues profesionistësh teknikë. Përbërja, autorizimet dhe përgjegjësitë e komitetit teknik do të përshkruhen më tej në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

5. Në rastet kur një mosmarrëveshje nuk zgjidhet nga grupi punues, ajo do t'i paraqitet dhe do të negociohet nga Komiteti i Përbashkët Drejtues dhe, në qoftë se përsëri nuk zgjidhet, përfundimisht do të trajtohet me anë të konsultimeve ndërmjet Palëve, e kur është e nevojshme edhe nëpërmjet kanaleve diplomatike.

6. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin e këtij Traktati, e cila nuk mund të zgjidhet me negociata, me kërkesë të njëres prej tyre, do të dërgohet në arbitrazh. Nëse brenda gjashtë [6] muajve nga data e kërkesës për arbitrazh, Palët nuk janë në gjendje të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, cilado prej Palëve mund t'ia referojë mosmarrëveshjen Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (GJPA) në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të GJPA-së 2012.

Neni 38 *Përgjegjësia*

1. Çdo përmbushje e këtij Traktati dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij, e detyron Palën që dështon në përmbushjen e detyrimeve t'ia kompensoj Palës tjetër të gjitha dëmet e shkaktuara.

2. Pala do të jetë përgjegjëse për veprimet, lëshimet ose sjelljet e tjera të një pale të tretë të cilës ajo Palë ia ka besuar përmbushjen e detyrimeve të asaj Pale sipas këtij Traktati dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij, në të njëjtën mënyrë sikur ajo Palë është përgjegjëse për veprimet, lëshimet ose sjelljet tjera të veta.

Neni 39 *Forca madhore*

1. Në rast se ndodh ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një shembull i forcës madhore e cila parandalon përmbushjen e pjesës ose të plotë të këtij Traktati dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, Pala duhet të njoftojë me shkrim Palën tjetër lidhur me faktet përkatëse. Pas marrjes së njoftimit, Palët hyjnë në dialog për të përcaktuar nëse ky Traktat dhe detyrimet që rrjedhin prej tij mund të ndryshohen sipas kushteve të pranueshme.

2. Shembull i forcës madhore nënkupton të gjitha rrethanat përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës përkatëse, duke përfshirë por pa u kufizuar në fatkeqësitë natyrore, luftërat, trazirat, trazirat civile, zjarrin, shpërthimet, terrorizimin, sabotimin, grevën, mbylljen, ngadalësimin, çrregullimet në punë, aksidentet, epidemitë, pandemitë, prishjen e shërbimeve publike, urdhrat ose dekretet e ndonjë gjykate, dhe veprimet e jashtëzakonshme nga Palë të treta.

Neni 40
Ndryshimi

Ky Traktat mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Shtetit Dërgues dhe Shtetit Pranes nëpërmjet shkëmbimit të letrave dhe në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

Neni 41
Përfundimi i shfrytëzimit të Burgut

1. Me përfundimin e këtij Traktati, Shteti Dërgues do të sigurojë që shfrytëzimi i Burgut të përfundojë dhe që asnjë i Burgosur ose pasuri e sjellë në Burg nga Shteti Dërgues të mos mbetet në Burg. Shteti Dërgues do t'ia kthejë Burgun Shtetit Pranes në gjendjen që është në momentin e përfundimit të afatit të Traktatit. Shteti Dërgues nuk do të zhbëjë asnjë rregullim të hërë në objekte,


Neni 42
Hyrja në fuqi

Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim me rastin e plotësimit të kërkesave ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të këtij Traktati. Ky Traktat hyn në fuqi në datën e pranimit të njoftimit të fundit.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të poshtëshënuarit e autorizuar kanë nënshkruar këtë Traktat.

COPENHAGEN 16.05.2022
E nënshkruar në dy kopje në *PRISHITINE*, më *26.04.2022* në gjuhën angleze, shqipe dhe daneze, të gjitha teksteve njëloj autentike. Në rast të ndonjë dallimi në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Për Republikën e Kosovës,



Për Mbretërinë e Danimarkës,

